

MINISTRJA EKONOMI NË TAKIMIN RAJONAL TË OSBE, QEVERIA SHQIPTARE VULLNET TË PALËKUNDUR NË LUFTËN NDAJ KORRUPSIONIT

U zhvillua takimn rajonal të organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë. Konferenca mbledhi bashkë të ftuar nga media dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga vendet e Europës Juglindore. Takimi kishte në fokus forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe gazetarëve investigativë në monitorimin dhe investigimin e përdorimit të fondeve publike nëpërmjet të dhënave të hapura në open data. Në fjalën e saj përshëndetëse Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi rikonfirmoi vullnetin e palëkundur të qeverisë shqiptare në luftën kundër korrupsionit, si një nga prioritetet kryesore të mirëqeverisjes dhe rolin e digjitalizimit në të. Ajo informoi se KPP-së i është akorduar një cmim rajonal për performancë të mirë në Balkan nga RESPA, për transformimin digjital të kryer, ku numri i ankesave është ulur falë edhe funksionimit më të mirë të prokurimeve online.



KOMITETI SHUMËPALËSH MBI PARTNERITETIN PËR QEVERISJE TË HAPUR (OGP)

Gjatë muajit Nëntor u zhvilluan dy takimet e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP). Me praninë e ministrave, zëvendës ministrave të ngarkuar me OGP-në, drejtues institucionesh publike, anëtarë të Shoqërisë Civile, dhe të ftuar të përhershëm nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Delegacionit të Bashkimit Europian.

Ky komitet siguron një strukturë për komunikim të rregullt, shumëpalësh midis qeverisë dhe aktorëve kryesorë të shoqërisë civile, duke mundësuar transparencë, përgjegjshmëri, forma inovatore për një politikbërje më gjithëpërfshirëse.



DOKUMENTI I POLITIKAVE

U zhvillua në Tiranë takimi mbi projekt-dokumentin "Dokument i politikave për standardet e shërbimeve publike në Shqipëri", ku Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi prezantoi në prani të Koordinatorës së Përhershme të OKB-së në Tiranë Fiona McCluney, përfaqësues nga Banka Botërore, SIGMA/OECD, institucione shtetërore, organizata jo-qeveritare dhe ekspertë të fushës këtë draft dokument. Dokumenti i politikave të standardeve të shërbimeve në Shqipëri, paraqitur për konsultim publik, shqyrton sfidat që hasen në përkufizimin e standardeve të shërbimeve publike, si dhe paraqet kornizën e përgjithshme dhe zgjidhjet praktike të matjes së cilësisë së shërbimeve për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të tyre.



MINISTRJA EKONOMI TAKON PËRFAQËSUESËN SPECIALE TË KRYESISË MBI ANTI-KORRUPSIONIN NË OSBE


Gjatë aktivitetit të organizuar nga OSBE, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi zhvilloi një takim me Përfaqësuesen Speciale të Kryesisë mbi Anti-Korrupsionin Anita Ramasastry, shoqëruar nga Kryetarja në Detyrë e Prezencës së OSBE-së në Tiranë Clarisse Pastorzy, si dhe përfaqësues të zyrës së Koordinatorit mbi Çështjet Ekonomike Mjedisore të OSBE-së në Vjenë rikonfirmoi vullnetin e palëkundur të qeverisë shqiptare në luftën kundër korrupsionit, si një nga prioritetet kryesore të mirëqeverisjes dhe rolin e digjitalizimit në një qasje sa më transparente.



MINISTRJA EKONOMI MERR PJESË NË FORUMIN GLOBAL "NDËRTIMI I BESIMIT DHE FORCIMI I DEMOKRACISË"

Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi ishte e ftuar në Forumin Global "Ndërtimi i besimit dhe forcimi i demokracisë" të organizuar nga OECD në Luksemburg në 17-18 Nëntor 2022. Në Forum merrnin pjesë ministra të vendeve anëtare të OECD-së, përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Në këtë Forum i cili u hap me përshëndetjet e Kryeministrit të Luksemburgut Xavier Bettel dhe Kryeministrit të Belgjikës Alexander De Croo, të gjithë pjesëmarrësit trajtuan çështje dhe dhanë ide që do të ndikojnë në politikat e forcimit të besimit ndaj institucioneve publike dhe sfidave kryesore të qeverisjes demokratike në erën digjitale.





SHQIPËRIA, RAST SUKSESI NË SHËRBIMET PUBLIKE ONLINE

Në Forumin Global të OECD-së, që u zhvillua në Luksemburg, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi, pati mundësinë të takonte dhe të shkëmbente disa ide me Mathieu Bousquet, Drejtorin në detyrë DG NEAR, BE. Ministrja Ekonomi u shpreh se në këtë kohë të re kërcënimesh globale, aftësitë më të rëndësishme të punonjësve civilë, duhet të jenë padyshim të lidhura me aftësinë për të menaxhuar "qëndrueshmërinë". Z.Bosquet, përgëzoi punën e deritanishme dhe avancimin e agjendës digjitale në Shqipëri, duke sjell një ndryshim cilësor në ofrimin e shërbimeve online.



EKONOMI-MAASSEN: QEVERISJA E HAPUR, E RËNDËSISHME PËR NJË SHOQËRI DEMOKRATIKE

Në ditën e dytë të punimeve të Forumit Global të OECD-së, që u zhvillua në Luksemburg, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi zhvilloi një takim bilateral me Sekretarin e Përgjithshëm të Iniciativës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) Paul Maassen. Ministrja Ekonomi diskutoi me Z. Maassen hapat që po ndërmerren qeveria shqiptare, në kuadër të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur, në përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile në qeverisje dhe në reformat që po ndërmerren.



SHQIPËRIA, 1 VIT KRYESIM TË BORDIT DREJTUES TË RESPA

U mbledh në Tiranë Bordi Drejtues i ReSPA-s, i cili për një vit kryesohej nga Shqipëria, nën drejtimin e Ministres së Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi. Me praninë e anëtarëve të tjerë të këtij bordi u vlerësuan arritjet e ReSPA dhe rezultatet e prekshme të saj me impakt në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në këtë periudhë kohore. Ministrja Ekonomi e vlerësoi të sukseshëm drejtimin e këtij bordi nga ana e Shqipërisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit rajonal në këtë drejtim.



MINISTRJA EKONOMI NË KONFERENCËN E RESPA, SHQIPËRIA MODEL PËR RAJONIN

Gjatë konferencës së organizuar në Tiranë sëbashku me ReSPA-n, të ftuar si Admirim Aliti, Ministër i Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës në Maqedoninë e Veriut, Gregor Virant, Drejtues i SIGMA, Florian Hauser DG Near-BE e të tjerë, ndanë me të pranishmit prezantimet e tyre mbi praktikën më të mira në rajon e më gjërë në funksion të reformave në administratën publike. Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve Milva Ekonomi, në panelin me temë "Modernizimi i Shërbimit Publik" diskutoi mbi hapat që po ndërmerren vendi ynë në tërheqjen dhe përthithjen në administratë të njerëzve të kualifikuar të cilët me nisjen e negociatave teknike me BE-në, kanë një rol domethënës në këtë proces.

RRITEN APLIKIMET NË E-ALBANIA

Sipas të dhënave të fundit të bëra publike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, falë sporteveve online në portalin E-Albania u mundësuan mbi 4.2 milionë aplikime për shërbime vetëm për maj-tetor 2022. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shifrat tregojnë një rritje prej 18.7%.

